



**VENDIM**

**Nr. 132 Datë 15.11.2013**

**PËR  
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË  
“BARDHGJANA” SH.P.K SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE  
NGA HEC “BISAK”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, dhe neneve 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 gërma “a”, të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “BARDHGJANA” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për Hec “Bisak” si burim i rinovueshëm energjie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “BARDHGJANA” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.  
Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**  
Përshkrimi i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “BARDHGJANA” sh.p.k si burim i rinovueshëm energjie nga Hec “Bisak”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**  
**Petrit AHMETI**